

KONTRATE SHITBLERJE

Lidhur ne Tirane, sot, me 29.03.2023 (dy mije e njezet e tre), ndermjet paleve te meposhtme:

SHITESI:

z. Besar Llapashtica, lindur ne Fier me 27.03.1990 dhe banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me numer 032266246 dhe numer personal J00327070S (ne vijim referuar si "Shitesi")

dhe

BLERESI:

Shoqeria "Albanian General Electricity" sh.a, e identifikuar me NUIS L41706021V, perfaqesuar nga administratori i saj Z. Besar Llapashtica, shtetas shqiptar, i lindur ne Fier, me 27.03.1990 dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me numer personal J00327070S (ne vijim referuar si "Bleresi")

(Bashkerisht referuar si "Palet")

BAZA LIGJORE:

Kodi Civil, Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar

DEKLARIME PARAPRAKE

Shoqeria "DRIBEN" sh.p.k, eshte person juridik i se drejtes shqiptare, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me nr. NUIS M02323016L, me seli ne adresen: Rruga "George W. Bush", Kullat perballe Parlamentit, Hyrja e I-re, Kati i 2-te, Tirane., me tej referuar si "Shoqeria"). Kjo shoqeri zoterohet nga:

- Z.Besar Llapashtica, zoterues i nje kuote te barabarte me 50% te kapitalit te shoqerise "Driben" sh.p.k;
- Z.Gerian Kuka, zoterues i nje kuote te barabarte me 50% te kapitalit te shoqerise "Driben" sh.p.k;

Shitesi kerkon te shese 1% te kapitalin qe zoteron ne shoqerine Driben sh.p.k tek Bleresi, ne perputhje me kushtet e kesaj kontrate.

Bleresi eshte i interesuar te bleje 1% te kapitalit te Shoqerise.

Per keto arsye, Palet, me vullnetin e tyre te plote, te lire e te pacenuar, vendosin te lidhin kete Kontrate Shitblerje (ne vijim referuar si "Kontrata"), me kushtet si me poshte vijon:

NENI 1 OBJEKTI

- 1.1. Objekti i kesaj Kontrate eshte percaktimi i kushteve, modaliteteve dhe pasojave te transakcionit mbi shitjen e 1% (nje perqind) te kapitalit te shoqerise, nga Shitesi tek Bleresi, sipas cmimit te percaktuar ne te.

NENI 2

Çmimi dhe menyra e pageses

- 2.1. Palet kane vendosur qe shitja e 1% te kapitalit te Shoqerise nga Shitesi tek Bleresi te jete me çmimin prej 5000 (pese mije leke). Ky çmim do te paguhet nga Bleresi me nenshkrimin e kesaj kontrate.
- 2.2. Çmimi do te paguhet nga Bleresi ne favor te Shitesit nepermjet transfertes bankare ne nje nga llogarite bankare te ketij te fundit.

NENI 3

Kalimi i titullit te pronesise

- 3.1. Titulli i pronesise se 1% te kapitalit te Shoqerise nga Shitesi tek Bleresi kalon ne momentin qe kryhet pagesa e plote ne llogarine e shitesit.

NENI 4

Efektet e shitjes

- 4.1. Palet bien dakord se pas nenshkrimit te kesaj Kontrate dhe kalimit te titullit te pronesise nga Shitesi tek Bleresi, Shoqeria do te kete kete strukture ortakesh:
 - Shoqeria "Albanian General Electricity" sh.a do te jete pronar i nje (1) kuote te barabarte me 1% te Kapitalit te Shoqerise.
 - Z. Besar Llapashtica do te jete pronar i nje (1) kuote te barabarte me 49% e Kapitalit te Shoqerise.
 - Z. Gerian Kuka do te jete pronar i nje (1) kuote te barabarte me 50% e Kapitalit te Shoqerise.

NENI 5

Garancite e Paleve

- 5.1. **Shitesi garanton Bleresin se:**

Pjeset e kapitalit qe ai zoteron ne shoqeri dhe qe jane objekt i shitblerjes sipas kesaj kontrate nuk jane subjekt barresimi, ndalimi shitje, te drejte parablerje, garancie bankare, apo e ndonje mjeti tjetër i cili siguron ekzekutimin e detyrimeve;

Ka te drejte, aftesi dhe zotesi te plote per te vendosur shitjen e pjeseve qe ai zoteron ne kapital dhe qe jane objekt i kesaj kontrate dhe per te ekzekutuar kete Kontrate sipas parashikimeve te saj, pa patur nevojën per pelqimin apo miratimin paraprak te ndonje personi tjetër, qofte ky fizik apo juridik;

NENI 6

Demshperblimi

- 6.1 Shitesi do t'i shperbleje Bleresit demin e shkaktuar, si dhe do ta perjashtojë atë nga pergjegjesia lidhur me çdo pretendim, dem, humbje, apo shpenzim, te ngritur ndaj

Shoqerise apo Bleresit lidhur me veprime te kryera, perpara nenshkrimt te kesaj Kontrate, apo qe rezulton si pasoje e:

- Çdo shkelje te garancive te Shitesit, parashikuar ne nenin 5.1 te kesaj Kontrate;
- Çdo shkelje te detyrimeve te Shitesit sipas kesaj Kontrate;

NENI 7 KONFIDENCIALITETI

Palet bien dakord qe kjo Kontrate dhe çdo negocim parakontraktor do te trajtohet ne perputhje me parimin e konfidencialitetit dhe se nuk do te transmetoje asnje te dhene apo informacion lidhur me marrredheniet tregtare, financiare apo ligjore te njera-tjetres, si dhe se nuk do te bejne asnje deklarate lidhur me ekzistencen, objektin apo parashikimet e kesaj Kontrate.

Palet perjashtohen nga detyrimi i ruajtjes se konfidencialitetit ne rast se:

- Pala tjetër ka dhene pelqimin per transmetimin e te dhenave;
- Transmetimi behet ne kuader te permbushjes se nje detyrimi;
- Nevojitet per kryerjen e nje detyre ligjore me interes publik;
- Keto te dhena jane bere publike nga vete pala tjetër dhe ndodhen ne domain-in publik dhe/ose jane te aksesueshme nga persona te trete;
- Keto te dhena jane bere publike ose i jane bere te njohura pales qe transmeton te dhenat nga persona te trete.

NENI 8 KOMUNIKIMI NDERMJET PALEVE

Te gjitha komunikimet ndermjet paleve, si dhe kerkesat qe ato kane ndaj njera tjetres, do te kryhen ne menyre shkresore ne adresat e percaktuara nga palet ne pjesen e gjeneraliteteve te tyre.

Ne rast se personat dhe/ose adresat e mesiperme pesojne ndryshime, Pala qe i peson ato ka detyrimin te njoftoje palen tjetër brenda 24 oresh nga momenti i ndryshimit. Ne rast te kundert, çdo komunikim ne adresen e meparshme do te konsiderohet i vlefshem edhe pse mund te mos jete marre nga ana e Pales qe ka ndryshuar personin e kontaktit dhe/ose adresen.

NENI 9 NDRYSHIMET E KONTRATES

Çdo ndryshim i kesaj Kontrate behet me pelqimin e perbashket te paleve dhe do te jete i vlefshem vetem ne rast se behet me shkrim dhe ne nenshkruhet nga te gjitha palet ne kete Kontrate.

NENI 10 Interpretimi i kontrates

Kushtet e percaktuara ne kete kontrate interpretohen pa u ndalur ne kuptimin letrar te fjaleve, por duke pasur parasysh qellimin e vertete te paleve, qe i ka shtyre per nenshkrimin e ketij akti. Kushtet e kontrates interpretohen njeri nepermjet tjetrit, duke i dhene secilit kuptimin qe del nga teresia e aktit. Ne rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen ne kuptimin ne te cilin mund te kene ndonje efekt dhe jo ne ate, sipas te cilit nuk do te kishte ndonje efekt.

Ligji i zbatueshem per interpretimin e kesaj Kontrate do te jete legjislacioni ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

**NENI 11
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

- 11.1 Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin ndermjet Paleve lidhur me kete Kontrate, palet duhet te perpiqen t'i zgjidhin me mirekuptim.
- 11.2 Nese nuk arrihet nje marreveshje, Kontrata do te jete objekt shqyrtimi gjyqesor dhe kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjes do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

**NENI 12
TE TJERA**

Bashkelidhur dhe pjese integrale e kesaj Kontrate jane:

- Kopje e leternjoftimit te paleve nenshkruese;
- Ekstrakt nga regjistri tregtar i Bleresit;
- Vendim i Asamblese se ortakeve te shoqerse Driben Sh.p.k
- Vendim i Asamblese se Aksionereve te shoqerise Albanian General Electricity sh.a


Kjo kontrate eshte hartuar ne 2 (dy) kopje origjinale ne gjuhen shqipe, nga nje per secilen pale nenshkruese.

Kjo kontrate hyn ne fuqi ne daten e nenskrimit te saj nga palet.

PALET:

SHITESI:

Z. Besar Llapashtica

Besar Llapashtica


BLERESI:

Albanian General Electricity sh.a
Perfaqesuar nga
Administratori
Z. Besar Llapashtica

Besar Llapashtica

